



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive  
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

# Monitoruesi i Prokurimit

Raport mbi Parregullsitë Ligjore të Ministrive, Komunave dhe  
Ndërmarrjeve publike (PTK & KEK)

Prill-Qershor, 2012



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



**CIVIL  
RIGHTS  
DEFENDERS**

# Monitoruesi i Prokurimit

Raport mbi Parregullsitë Ligjore të Ministrive, Komunave dhe Ndërmarrjeve publike (PTK & KEK)

Prill-Qershor, 2012

**Programi për Qeverisje të Mirë, financohet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) - i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)". Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Lëvizjes FOL dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo KCSF-së.

**Projekti “Mbështetja e politikave kundër-korrupsion duke forcuar mbikëqyrjen publike ndaj shërbimeve publike” financohet nga:**



Publikimi i këtij Raporti është përkrahur nga CRD. Qëndrimet e shprehura në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e CRD.

## Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	3
Shkeljet nga ana e ministrive	4
Ministria e Infrastrukturës	4
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	6
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	6
Shkeljet nga Ndërmarrjet Publike	7
Korporata Energjetike e Kosovës	7
Postë Telekomunikacioni i Kosovës	9
Shkeljet nga ana e Komunave	10
Komuna e Gjilanit	10
Komuna e Vitisë	10
Komuna e Ferizajt	11
Komuna e Kamenicës	11
Raportimet e Gazetave Ditore në Fushën e Prokurimit Publik	12
Rekomandimet	13
Falënderim	13
Lëvizja FOL	13

**Lista e Akronimeve/Shkurtesave**

**AK** Autoriteti Kontraktues

**CRD** - Civil Rights Defenders (Mbrojtësit e të Drejtave Civile)

**LPP** Ligji i Prokurimit Publik

**KEK** Korporata Energjetike e Kosovës

**KK** - Komisioni i Konkurrencës

**KRPP** Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

**MBPZHR** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**MI** Ministria e Infrastrukturës

**MKRS** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

**OE** Operator Ekonomik

**OSI** Open Society Institute

**OSHP** Organi Shqyrtues i Prokurimit

**PSH** Paneli Shqyrtues (Organ i OSHP-së)

**RPP** Rregullorja e Prokurimit Publik

## Përmbledhje Ekzekutive

Ministritë, Ndërmarrjet Publike (KEK dhe PTK) dhe Komunat e Republikës së Kosovës kanë vazhduar avazin e vjetër të shkeljeve dhe parregullsive ligjore në fushën e prokurimit publik. Përgjatë periudhës tremujore, prill-qershor 2012, këto institucione kanë bërë shkelje ligjore në gjithsej 13 tenderë të ndryshëm. Prej tyre 5 janë kthyer në ri-vlerësim nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, 7 janë kthyer në ri-tenderim dhe vetëm në 1 aktivitet prokurimi është marrë vendim për vazhdimin e procedurave të prokurimit.

Ministritë kanë shkelur dispozitat ligjore të prokurimit publik në gjithsej 4 tenderë: a) Ministria e Infrastrukturës në dy aktivitete të ndryshme prokurimi: “Mirëmbajtja Verore e Rrugëve Nacionale dhe Regjionale 2011/2012” dhe “Ndërtimi i rrugës lokale R115 (Prizren-Reqan) - Pouskë-Jablanicë” ; b) Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në tenderin “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Klinës - Faza e II-të”; si dhe c) Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja, zgjerimi dhe përforcimi i kadastrës të vreshtave dhe të industrisë së verës në rajonet e vreshtave të Republikës së Kosovës”. Prej tyre 2 aktivitete të prokurimit janë kthyer në ri-tenderim, 1 është kthyer në ri-vlerësim dhe 1 tjetër është vendosur të vazhdojë me procedurat e prokurimit.


Ndërmarrjet Publike (KEK dhe PTK) kanë bërë shkelje ligjore në 5 tenderë të ndryshëm. Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë shkelje ligjore në 3 aktivitete prokurimi: a) “Furnizim me shirit gome”; b) “Ruajtja dhe sigurimi i objekteve të KEK-ut”; si dhe c) “Shitja e Thëngjillit”. Ndërkaq, PTK ka bërë shkelje në gjithsej 2 tenderë: a) “Furnizimi dhe instalimi i kamerave monitoruese” dhe b) “Furnizim me Set Top Box”. 3 prej këtyre tenderëve janë kthyer në ri-vlerësim, ndërkaq 2 në ri-tenderim.

Komunat kanë bërë shkelje ligjore në gjithsej 4 aktivitete prokurimi. Komuna e Gjilanit ka shkelur dispozitat ligjore me rastin e anulimit të tenderit “Sanimi i rrugëve dhe trotuareve - Mirëmbajtja verore e rrugëve”; b) Komuna e Vitisë në aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi dhe shtruarja me zhavorr e trotuarit të rrugës nga Fshati i Ri - Ramjan”; c) Komuna e Ferizajt me rastin e tenderit “Furnizim me serra familjare - Ferizaj”; si dhe d) Komuna e Kamenicës në rastin e aktivitetit të prokurimit “Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore - Lot 2”. Prej këtyre tenderëve 3 janë kthyer në ri-tenderim, ndërkaq vetëm njëri 1 është kthyer në ri-vlerësim.

Përgjatë periudhës tremujore gazetatat ditore kanë publikuar gjithsej 62 artikuj të ndryshëm. Prej këtyre 62 artikujve gazetaresk 21 kanë qenë raportime hulumtuese: 6 në muajin prill, 8 në muajin maj dhe 7 në muajin qershor. Ndërkaq 41 sosh kanë qenë të publikuara në formën e lajmeve: 13 në muajin prill, 23 në muajin maj dhe 5 sosh në muajin maj.

### Shkeljet nga ana e Ministrive

Ministritë kanë shkelur dispozitat ligjore të prokurimit publik në gjithsej 4 tenderë të ndryshëm: a) Ministria e Infrastrukturës me rastin e tenderit “Mirëmbajtja Verore e Rrugëve Nacionale dhe Regjionale 2011/2012” dhe “Ndërtimi i rrugës lokale R115 (Prizren-Reqan) - Pouskë-Jablanicë, L=4438.16m” ; b) Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Klinës - Faza e II-të”.; c) Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në tenderin “Mirëmbajtja, zgjerimi dhe përforcimi i kadastrës të vreshtave dhe të industrisë së verës në rajonet e vreshtave të Republikës së Kosovës”. Prej tyre 2 aktivitete të prokurimit janë kthyer në ritenderim, 1 është kthyer në ri-vlerësim dhe 1 tjetër është vendosur të vazhdojë me procedurat e prokurimit.



Tab (1): Numri i vendimeve të OSHP-s për periudhën Prill-Qershor, 2012

### Ministria e Infrastrukturës

Ministria e Infrastrukturës (MI) ka bërë shkelje në tenderin “Mirëmbajtja Verore e Rrugëve Nacionale dhe Regjionale 2011/2012”. Shkeljet e tilla kanë ndodhur pasi Autoriteti Kontraktues në fjalë ka vendosur për shkëputje të kontratës me operatorët ekonomikë fitues. Duke parë parregullsitë e tilla ligjore, operatorët ekonomikë “Alko-Impex General Construction - shpk” nga Prishtina, “Integral shpk” nga Prishtina, “Tali” nga Gjilani, “Arbotec” nga Suhareka, “R.S.M. & Eskavatori” nga Prishtina, “Driny Company” nga Prizreni, “Graniti shpk” nga Istogu, “Jasen & Kastrioti nga Zubin Potoku, si palë të pakënaqura kanë parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik. Pretendimet kryesore ankimore të operatorëve ekonomikë që janë dorëzuar në OSHP konsistojnë:

- Shkelje e nenit 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Shkelje e nenit 7 - Barazia në trajtim/jo-diskriminim
- Shkelje e nenit 8 - Planifikim i prokurimit
- Shkelje e nenit 9 - Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur
- Shkelje e nenit 10 - Mjetet për promovimin e transparencës
- Shkelje e nenit 27 - Dosja e Tenderit

- Shkelje e nenit 28 - Specifikimet e Tenderit
- Shkelje e nenit 29 - Variantet e specifikimeve teknike
- Shkelje e nenit 38 - Kontratat publike kornizë
- Shkelje e nenit 41 - Njoftimi mbi dhënien e kontratës
- Shkelje e nenit 42 - Publikimi i njoftimeve
- Shkelje e nenit 43 - Forma dhe përmbajtja e njoftimeve dhe
- Shkelje e nenit 55 - Mënyrat e komunikimit

Më pas, për t'i analizuar pretendimet ankimore të këtyre operatorëve ekonomikë OSHP ka caktuar ekspertët shqyrtues. Në ekspertizën e tyre ekspertët kanë konstatuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 6, 7, 13, 39 dhe 42 të LPP-së. Më tej, pas dëgjimit të provave në seancën dëgjimore të organizuar nga PSH, ekspertët kanë konstatuar se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje duke shkëputur kontratën, sepse sipas të gjeturave të tyre kontrata nuk ka pasur karakter sezonal dhe se kontrata ka përmbajtur periudhën e parashikuar për realizimin e punëve të kryera. Duke parë parregullsitë e tilla, Paneli Shqyrtues ka aprovuar konstatimet e ekspertëve shqyrtues dhe ka konstatuar se me rastin e shkëputjes së kontratës Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik, duke qenë se AK urdhërohen që të bëjnë përdorimin sa më të arsyeshëm dhe ekonomik të burimeve publike. Me këtë rast OSHP-ja ka anuluar vendimin e Ministrisë së Infrastrukturës.

Përveç këtyre shkeljeve në këtë tender, Ministria e Infrastrukturës ka bërë shkelje edhe në aktivitetin tjetër të prokurimit: “Ndërtimi i rrugës lokale R115 (Prizren-Reqan) - Pouskë-Jabllanicë, L=4438.16m”.<sup>1</sup> Ky aktivitet i prokurimit është publikuar gjatë muajit maj, ndërkaq pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve Komisioni Vlerësues ka rekomanduar për kontratë OE “Driny Company”. Pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, operatorët ekonomikë “Teknika Projekt”, “Viacom” “Sed Tours” kanë parashtruar ankesat e tyre në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik. Bazuar në ankesave e tyre Ministria e Infrastrukturës ka eliminuar padrejtësisht ato duke i shpallur si operatorë të papërgjegjshëm. Me gjithë pretendimet e palëve ankimore, eksperti shqyrtues i kësaj lëndë ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues me të drejtë i ka shpallur si të papërgjegjshme, duke qenë se asnjëra prej tyre nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara sipas Dosjes së Tenderit.

Mirëpo sipas ekspertizës së ekspertit shqyrtues as operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës “Driny Company” nuk ka përmbushur kriteret e kërkuara sipas Dosjes së Tenderit. Kjo për arsye se “Driny Company” ka ofruar një licensë me afat të skaduar për prodhimin e asfaltit, si dhe menaxheri i caktuar nga ana e saj ka tejkalluar moshën e lejuar me Ligjin e Punës së Republikës së Kosovës. Prandaj, me këtë rast Paneli Shqyrtues ka konstatuar se Komisioni Vlerësues (i përbërë prej tre anëtarëve) nuk ka respektuar nenin 59 të Ligji për Prokurimin Publik, me ç’rast këtë lëndë e ka kthyer sërish në rivlerësim.

---

<sup>1</sup> Ministria e Infrastrukturës gjatë muajit prill ka filluar këtë procedurë të prokurimit duke publikuar njoftimin për kontratë, vlera e të cilës është planifikuar të jetë e lartë. Ndërkaq, hapja e ofertave është bërë me 17 maj, 2012.

### Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

MKRS ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-së me rastin e aktivitetit të prokurimit “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Klinës - Faza e II-të”. Në këtë tender sipas palës ankimore “R&Rukolli” janë shkelur një sërë dispozitash ligjore, por shkelja më e madhe sipas saj ka ndodhur se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar si dëshmi Draft-Kontratën mbi sigurimin e vend-ndërtimit me një kompani të licencuar dhe të njohur të sigurimeve, ashtu siç është kërkuar në pikën 8 të kërkesave mbi përshtatshmërinë në Dosjen e Tenderit. Megjithëse me pretendimet e palës ankimore nuk është pajtuar eksperti shqyrtues i këtij aktiviteti të prokurimi, Paneli Shqyrtues ka vendosur që këtë tender ta kthejë në **ri-tenderim** pikërisht për shkakun se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës “KAWA Group & BAMIRS” nuk ka ofruar dëshminë e Draft-Kontratës.

### Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Bujqësisë ka bërë shkelje të shumta të dispozitave ligjore në aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja, zgjerimi dhe përforcimi i kadastrës të vreshtave dhe të industrisë së verës në rajonet e vreshtave të Republikës së Kosovës”. Sipas të gjeturave të ekspertit shqyrtues dhe Panelit Shqyrtues rezulton se AK gjatë hartimit të Dosjes së Tenderit ka vepruar në kundërshtim me nenin 52, i cili specifikon se “vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kriteret që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kriteret e tilla mund të jenë në lidhje me p.sh., cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistencë teknike”.<sup>2</sup>


Më tutje, kërkesa e Ministria e Bujqësisë për certifikatën e cilësisë të softuerit dhe data bazën e kërkuar PosGIS është cilësuar si kërkesë kufizuese dhe në kundërshtim me nenin 7 dhe 28 të Ligjit për Prokurim Publik. Për më tepër, MBPZHR ka kërkuar një numër pajisjesh të caktuara me emërtime të prodhuesve me karakteristika funksionale të caktuara e po ashtu edhe me performansa të caktuara, gjë që bie ndeshë me nenin 28 dhe 7 të LPP-së. Me këtë rast OSHP-ja ka kthyer këtë tender në **ri-tenderim** dhe operatorit ekonomik ankues i ka kthyer shumën prej 500.00 Euro.

<sup>2</sup> Me hollësisht shih paragrafin nenin 52.4 i Ligjit për Prokurim Publik, Kuvendi i Kosovës, 29 gusht 2011, fq. 49



### Shkeljet e Ndërmarrjeve Publike<sup>3</sup>

Ndërmarrjet Publike (KEK dhe PTK) kanë bërë shkelje ligjore në pesë (5) tenderë të ndryshëm. Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë shkelje ligjore në tre (3) aktivitete të prokurimit: a) “Furnizim me shirit gome”; b) “Ruajtja dhe sigurimi i objekteve të KEK-ut”; si dhe c) “Shitja e Thëngjillit”. Ndërkaq, PTK ka bërë shkelje në gjithsej dy (2) tenderë të ndryshëm: a) “Furnizimi dhe instalimi i kamerave monitoruese” dhe b) ”Furnizim me Set Top Box”. Tre prej këtyre tenderëve janë kthyer në ri-vlerësim, ndërkaq dy në ri-tenderim.



**Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)** - ka bërë shkelje në tri aktivitete të ndryshme të prokurimit. Në tenderin e parë, “Furnizim me shirit gome”. Fillimisht, kompania nga Prishtina “NTSH EKOINVEST” është ankuar tek Organi Shqyrtues i

Tab (2): Numri i vendimeve të OSHP-s për periudhën Prill-Qershor, 2012

Prokurimit Publik kundër njoftimit për dhënie të kontratës operatorit tjetër ekonomik “NEW KO Balkan”, duke pretenduar se Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së:

- Neni 59.4 të LPP-së - ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60.1.1. të LPP-së - kriteret për dhënie të kontratës

Pas pranimit të ankesës Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka autorizuar ekspertin shqyrtues për ta shqyrtuar aktivitetin e prokurimit si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore. Eksperti shqyrtues në raportin e tij ka konstatuar se ÄK ka caktuar kryetar të Komisionit Vlerësues zyrtarin e prokurimit duke vepruar kësisoj në kundërshtim me nenin 34.4. të udhëzuesit operativ për prokurimin publik, ku shkruan se “Zyrtari i Prokurimit dhe/ose anëtarët e stafit të Departamentit të Prokurimit nuk do të shërbejë si anëtarë të Komisionit Vlerësues. Zyrtari i Prokurimit do të udhëheq Komisionin Vlerësues të tenderit pa të drejtë vote. Ai/ajo do të organizojë, këshillojë dhe drejtojë punën e KV dhe do të sigurojë respektimin e dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik. Më tej, eksperti ka pohuar se operatori ekonomik ankues ka ofruar çmim më të lirë për totalin

<sup>3</sup> Duke qenë se ekzistojnë shumë ndërmarrje publike, FOL monitoron vetëm dy ndërmarrjet kryesore në vend: KEK-un dhe PTK-në.

e njësisë, ndërsa operatori i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmim më të lirë për vlerën totale të kontratës.

Eksperti shqyrtues gjithashtu ka konstatuar se ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me kontratë publike kornizë, ndërsa ka theksuar se AK nuk ka dhënë ndonjë dëshmi praktike profesionale për mundësinë e realizueshmërisë në përqindje të sasive të përafërta për secilin produkt veç e veç. Duke parë shkeljet e tilla ligjore, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka vendosur që këtë aktivitet të prokurimit ta kthejë në **ri-vlerësim**. Megjithatë, Korporata Energjetike e Kosovës edhe pas procesit të ri-vlerësimit ka rekomanduar për kontratë operatorin e njëjtë. Kjo ka detyruar OSHP-në që të lëshojë dy urdhëresa, ku specifikohet se AK duhet t'i përmbahet vendimit paraprak për ri-vlerësim të ofertave.

Përveç shkeljeve në këtë tender, Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë shkelje edhe me rastin e anulimit të tenderit tjetër “Ruajtja dhe sigurimi i objekteve të KEK-ut”. Kompania “Security Code”, si palë e pakënaqur, ka ushtruar ankesë duke pretenduar se KEK-u ka bërë shkelje të:

- Nenit 62 të LPP-së - Përfundimi i aktivitetit të prokurimit
- Nenit 109.1 të LPP-së - Afatet për dorëzimin e ankesës
- Nenit 38.4 të LPP-së - Udhëzuesit Operativ të KRPP-së

Pas pranimit të ankesës OSHP-ja ka caktuar ekspertin shqyrtues, me ç'rast ka konstatuar se KEK-u nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së që rregullon çështjen e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Megjithatë, me raportin e ekspertit nuk janë pajtuar zyrtarët e KEK-ut, të cilët në seancën dëgjimore të organizuar nga PSH kanë pohuar se deri tek anulimi i këtij tenderi kanë ardhur pas vlerësimit të Agjencisë Kundër Korrupsion. Mirëpo, eksperti shqyrtues ka pohuar se në këtë aktivitet të prokurimit nuk kanë nevojë të ndërhyjnë autoritetet tjera, duke nënkuptuar këtu Agjencinë Kundër Korrupsion. I të njëjtit mendim ka qenë edhe Paneli Shqyrtues, i cili ka pohuar se “Anulimi i këtij tenderi mbi bazën e një opinionit të dhënë nga Agjencia Kundër Korrupsion” nuk justifikon vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e këtij tenderi. Me këtë rast Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka vendosur që këtë aktivitet të prokurimit ta kthejë në **ri-vlerësim**.

Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë shkelje ligjore edhe në tenderin tjetër “Shitja e Thëngjillit”. Bazuar në të gjeturat e ekspertit rezulton se një referencë e konsorciumit të rekomanduar për kontratë është lëshuar nga kompania private “AL TRADE”, mirëpo eksperti ka pohuar se në Dosjen e Tenderit është kërkuar që referencat duhet të shoqërohen me dokumentacione si: përmbledhja e kontratave dhe certifikata e përfundimit apo diçka ekuivalente, ndërsa referenca e lëshuar nga “AL TRADE” nuk e ka të bashkangjitur kontratën.

Ndërkaq, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, në të cilën janë prezantuar provat dhe dëshmitë e palëve në këtë kontest, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se AK gjatë zhvillimit të procedurës për shitje dhe heqje të aseteve ka rekomanduar për kontratë konsorciumin me çmimin më të lartë të ofruar dhe se AK me rastin e rekomandimit për kontratë nuk iu ka përmbajtur kërkesës B.1. të Dosjes për shitje të thëngjillit, ku është kërkuar që “aplikuesi duhet të dorëzojë së paku dy referenca të kontratës të cilat dokumentojnë

përdorimin e teknologjisë diskontinuale për largimin e thëngjillit, mineraleve ose materialit të ngjashëm dhe thërrmimi i materialeve të tilla në sasi së paku 50 000 tonësh në 12 muajt e fundit dhe referencat e tilla duhet të shoqërohen me dokumentacione si përmbledhja e kontratave dhe certifikatave e përfundimit apo diçka ekuivalente. Duke parë parregullsitë e tilla të evidentuara nga operatori ekonomik ankues, nga eksperti shqyrtues, PSH ka vendosur që këtë aktivitet të prokurimit ta kthejë në **ri-tenderim**.

**Postë-Telekomi i Kosovës** - ka bërë shkelje të shumta ligjore në dy tenderë të ndryshëm: a) “Furnizimi dhe instalimi i kamerave monitoruese” dhe b) “Furnizim me Set Top Box”. Në rastin e aktivitetit të parë të prokurimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka vendosur që ta kthejë në ri-tenderim. Deri tek një vendim i tillë është ardhur pas shqyrtimit të palës ankuese, operatorit ekonomik “RI45 Technologies” nga Prishtina, raporti të ekspertit shqyrtues dhe konstatimeve të Panelit Shqyrtues. OSHP në vendimin e saj ka pohuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 112 të Ligjit për Prokurimin Publik (efekti pezullues i ankesës), duke e zhvilluar procedurën e hapjes së ofertave edhe përkundër vendimit të OSHP-së për pezullim pas ankesës së parashtruar nga “RI45 Technologies”. Arsyeja e pezullimit të këtij aktiviteti është bërë për shkakun se Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar specifikime teknike që i referohen një pajisje “Switch”, gjë që me paragrafin 7 të nenit 28 të LPP-së ndalohet një gjë e tillë. Në këtë paragraf specifikohet se “autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi”. Me këtë rast, OSHP-ja ka vendosur që këtë tender ta kthejë në **ri-tenderim**.

Në rastin e tenderit të dytë, “Furnizim me Set Top Box”, PTK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 51.2 (Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes)<sup>4</sup> dhe 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)<sup>5</sup> të Ligjit për Prokurim Publik. Operatori ekonomik “NTSH Ekoinvest & Dsc. d.o.o”, si palë e pakënaqur, ka parashtruar ankesë duke pretenduar se Posta dhe Telekomi i Kosovës e ka eliminuar padrejtësisht nga konkurrenca si ofertues në këtë tender. Këto pretendime janë konfirmuar edhe nga të gjeturat e raportit të ekspertit shqyrtues të kësaj lënde. Kjo për shkakun se ky Autoritet Kontraktues nuk e ka specifikuar që deklarata mbi themelimin e grupit të operatorëve ekonomikë duhet të dorëzohet në origjinal nga tenderuesit të cilët tenderojnë si grup i


<sup>4</sup> Paragrafi i këtij neni e specifikon se “Autoriteti kontraktues duhet: (i) të përcaktojë në njoftimin e kontratës, aq sa është e mundshme, të gjitha dokumentet dhe informatat e tjera që operatorët e interesuar ekonomik duhet të dorëzojnë së bashku me tenderin apo kërkesën për pjesëmarrje; dhe (ii) të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit, të gjitha dokumentet dhe informatat në fjalë. Të gjitha këto kërkesa për dokumente dhe informata do të kufizohen vetëm në aq dokumente dhe informata sa është e nevojshme për ti lejuar autoritetit kontraktues që të verifikojë se operatori përkatës ekonomik: (i) nuk konsiderohet i papërshtatshëm sipas nenit 65 të këtij ligji, dhe (ii) nëse aplikohet, i përmbush kriteret minimale të përzgjedhjes të saktësuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në asnjë rast njoftimi i kontratës ose dosja e tenderit nuk do të kërkojnë nga operatori i interesuar ekonomik që të dorëzojë dokumente ose informata që nuk kërkohen ose nuk janë në përputhshmëri me nenet 65-70 të këtij ligji.

<sup>5</sup> Në këtë paragraf shkruan se “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.

operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka urdhëruar autoritetin në fjalë që këtë aktivitet të prokurimit ta kthejë edhe njëherë në ri-vlerësim.

### Shkeljet nga ana e Komunave

Komunat kanë bërë shkelje ligjore në gjithsej 4 tenderë të ndryshëm. Komuna e Gjilanit ka shkelur dispozitat ligjore me rastin e anulimit të tenderit “Sanimi i rrugëve dhe trotuareve - Mirëmbajtja verore e rrugëve”; Komuna e Vitisë në aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi dhe shtruarja me zhavorr e trotuarit të rrugës nga Fshati i Ri - Ramjan”; Komuna e Ferizajt me rastin e tenderit “Furnizim me serra familjare - Ferizaj”; si dhe Komuna e Kamenicës në rastin e aktivitetit të prokurimit “Hartimi i projekteve ideore dhe



kryesore - Lot 2”. Prej këtyre tenderëve tre (3) janë kthyer në ri-tenderim, ndërkaq vetëm njëri (1) është kthyer në ri-vlerësim.

Tab (3): Numri i vendimeve të OSHP-s për periudhën Prill-Qershor, 2012

**Komuna e Gjilanit** - ka bërë shkelje me rastin e anulimit të tenderit “Sanimi i rrugëve dhe trotuareve - Mirëmbajtja verore e rrugëve”. Pasi ankesës së ushtruar nga ana e OE “Tali”, OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues për ta analizuar në tërësi këtë aktivitet të prokurimit. Me këtë rast, eksperti ka konstatuar se gjatë procesit të vlerësimit të ofertave Komisioni nuk ka bërë shkelje të ndonjë dispozite ligjore dhe i ka rekomanduar AK që të vazhdojë me procedurat e mëtejme të prokurimit publik. Megjithatë, pas dëgjimit të provave të paraqitura seancës dëgjimore të organizuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, ky i fundit ka konstatuar se Komuna e Gjilanit ka bërë shkelje të nenit 27 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke qenë se nuk ka respektuar procedurat e parapara që rregullojnë hartimin e kriterëve të përzgjedhjes në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Përveç kësaj, Komuna e Gjilanit ka përzier referencat e menaxherit të projektit me referencat për punë të operatorit ekonomik. Me këtë rast OSHP-ja e ka kthyer këtë aktivitet të prokurimit në **ri-tenderim**.

**Komuna e Vitisë** - ka bërë shkelje të shumta në tenderin “Zgjerimi dhe shtruarja me zhavorr e trotuarit të rrugës nga Fshati i Ri - Ramjan”. Në këtë aktivitet prokurimi Komuna e Vitisë ka bërë shkelje të shumta të dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurim Publik, përkatësisht nenin 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti), nenin 38 (Kontratat Publike Kornizë),

59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) dhe 62 (Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit). Pas evidentimit të këtyre shkeljeve, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka vendosur që këtë tender ta kthejë në ri-vlerësim dhe që operatorët ekonomikë tenderues të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të mos diskriminohen.

Ndërkaq, si pikë pozitive e kësaj komune është që gjatë kësaj periudhe kohore ka përpiluar një Listë të Zeze, e cila përmban numrin e kompanive që nuk kanë përmbushur më parë kontratat e fituara. Një vendim të tillë e ka aprovuar edhe Organi Shqyrtues i Prokurimit.

**Komuna e Ferizaj** - ka bërë shkelje me rastin e aktivitetit të prokurimit “Furnizim me serra familjare - Ferizaj”. Bazuar në të gjeturat e Operatori Ekonomik “NSH Kastrioti” nga Ferizaj, që është ankuar te Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, operatori i rekomanduar për kontratë nuk ka poseduar veprimtari adekuate për bujqësi, ka specifikuar në mënyrë diskriminuese vendin e mallit dhe se kriteret e shpalljes së tenderit nuk janë përcjellë në Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Edhe eksperti shqyrtues i kësaj lëndë ka konstatuar në ekspertizën e tij se Komuna e Ferizaj ka vepruar në kundërshtim me nenin 28.7 të Ligjit për Prokurim Publik, ku shkruan se “Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenjë dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi”.<sup>6</sup> Duke parë parregullsitë e tilla, Paneli Shqyrtues ka vendosur që këtë aktivitet të prokurimit ta kthejë në ri-tenderim (nëse eventualisht AK shpreh interesim për këtë tender).

**Komuna e Kamenicës** - ka bërë shkelje të shumta ligjore në tenderin “Hartimi I projekteve ideore dhe kryesore - Lot 2”. Në këtë aktivitet të prokurimit Komuna e Kamenicës ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik “3D - Project”. Mirëpo, pas njoftimit për dhënie të kontratës operatori tjetër ekonomik “Infratek” nga Prishina ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së me pretendimin se Komuna e Kamenicës gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 30.1 të Dosjes së Tenderit, pasi nuk ka respektuar çmimin më të lirë që e ka ofruar vetë ajo.


Edhe eksperti shqyrtues në ekspertizën e tij ka pohuar se Komuna e Kamenicës e ka specifikuar kriterin për dhënie të kontratës - çmim më i ulët, ndërkaq në anën tjetër ka vendosur ta shpërblejë operatorin ekonomik gazuar në kriterin ‘ekonomikisht më i favorshëm’. Pasi që Komuna e Kamenicës nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit, që këtë tender ta kthejë në ri-vlerësim, është mbajtur edhe séance dëgjimore nga ana e OSHP-së, me ç’rast është nxjerrë vendimi për ri-tenderim dhe hedhje poshtë të pretendimeve të AK në fjalë.

---

<sup>6</sup> Me gjerësisht shih Ligjin për Prokurim Publik, Kuvendi i Kosovës, 29 gusht 2011, fq. 2

### Raportimet e Gazetave në Fushën e Prokurimit Publik

Raportimet e gazetave ditore<sup>7</sup> në fushën e prokurimit publik përbëjnë një rëndësi të jashtëzakonshme në eliminimin e parregullsive ligjore dhe praktikave korruptive. Përgjatë periudhës tremujore gazetaret ditore kanë publikuar gjithsej 62 artikuj të ndryshëm. Prej këtyre 62 artikujve gazetaresk 21 kanë qenë raportime hulumtuese: 6 në muajin prill, 8 në muajin maj dhe 7 në muajin qershor. Ndërkaq 41 sosh kanë qenë të publikuara në formën e lajmeve: 13 në muajin prill, 23 në muajin maj dhe 5 sosh në muajin maj.



<sup>7</sup> Në kuadër të hulumtimit tonë kemi zgjedhur vetëm katër gazetaret kryesore ditore në Kosovë: Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot dhe gazeta Express.

**Rekomandimet:**

1. Lëvizja FOL rekomandon që çmimet e ofruara për tenderë të ndryshëm të jenë jashtë dosjeve të tenderit - në mënyrë që të evitohet mundësia e keqpërdorimeve;
2. Lëvizja FOL rekomandon që Autoritet Kontraktuese të lejojnë qasjen e mbikëqyrjes së shoqërisë civile në procesin e prokurimit publik;
3. Lëvizja FOL i rekomandon OSHP-së dhe AK që të ndërmarrin masa ndëshkuese për zyrtarët e prokurimit që bëjnë shkelje të qëllimshme të dispozitave ligjore dhe atyre të rregulloreve;
4. Lëvizja FOL rekomandon që Autoritetet Kontraktues të raportojnë rastet në Prokurori kur Operatorët Ekonomikë provojnë të bëjnë falsifikim të dokumenteve dhe mashtrimeve të natyrave tjera;
5. Lëvizja FOL rekomandon që, përveç AQP-së, Autoritetet Kontraktuese ta involvojnë edhe Komisionin i Konkurrencës - në rast të tenderëve jo-normalisht të ulët (që përmbajnë çmime që dëmtojnë konkurrencën);
6. FOL rekomandon që dosjet e tenderëve të thjeshtëzohen dhe hartimi i tyre të bëhet më me kujdes, në mënyrë që të shmangen format e ndryshme të diskimit dhe trajtimit jo të barabartë të ofertuesve, duke ndikuar në reduktimin e ankesave nga OE.

## Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Mbrojtësit e të Drejtave Civile dhe Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë. Ky Raport është produkt i stafit të Lëvizjes FOL dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ueb faqe: [www.levizjafol.org](http://www.levizjafol.org)

## Rreth Lëvizjes FOL

Organizata është themeluar të mbështes qytetarin aktive, të rris transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit. Për t'i përmbushur qëllimin e saj, organizata do të ndër marrë aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, avokim si dhe mbështetje teknike dhe institucionale, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive  
Supporting Good Governance and Active Citizenry*



Rr. Andrea Gropa, Nr. 35. 10000 Prishtinë, Kosovë

Mob.: +377 (0) 44 131 542 | [www.levizjafol.org](http://www.levizjafol.org) | [info@levizjafol.org](mailto:info@levizjafol.org)

Programi për Qeverisje të Mirë është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) - i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).